Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

-
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>		<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
<i>1</i>	Mirëmbajtja dhe Auditim Vjetor i Certifikatës ISO27001 në OST sh.a.	Komplet	1			
					Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Mirëmbajtja dhe Auditim Vjetor i Certifikatës ISO27001 në OST sh.a.”.

Afatet e ekzekutimit: 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përshkrimit të bërë në Termat e References Shtojca 8.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	“Mirëmbajtja dhe Auditim Vjetor i Certifikatës ISO27001 në OST sh.a.”.		Sipas Termave të References	3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përshkrimit të bërë në Termat e References Shtojca 8

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

1. Qëllimi i Projektit

Për përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj, OST sh.a. administron infrastrukturën dhe sistemet më kritike të teknologjisë së informacionit në nivel kombëtar. Duke qenë se furnizimi me energji është thelbësor për jetën socio-ekonomike, infrastruktura e OST sh.a. konsiderohet jetike.

Ndërsa sistemet IT më parë funksiononin të izoluara, sfida aktuale është integrimi dhe shkëmbimi i vazhdueshëm i të dhënave, i cili rrit ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike. Për këtë arsye, OST sh.a. përdor sistemin SCADA/EMS si platformë kryesore të qendrës së kontrollit, duke mundësuar operim të sigurt të sistemit të transmetimit dhe informacion të besueshëm operativ.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE), me Vendimin Nr.126, datë 30.07.2020, ka miratuar “Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, e cila në nenin 10 kërkon që të gjithë operatorët e infrastrukturave kritike të jenë të certifikuar sipas standardit ISO 27001.

Gjithashtu, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 222, datë 26.04.2018, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK) ka klasifikuar Sistemin SCADA si “Infrastrukturë Kritike të Informacionit”, duke identifikuar edhe OST sh.a. si operator infrastrukture kritike të informacionit (OIKI).

OST sh.a. është e certifikuar me ISO 27001:2022 dhe, në përputhje me kërkesat e ISMS, duhet t'i nënshtrohet auditimit vjetor për të ruajtur vlefshmërinë e certifikatës. Duke marrë parasysh intensifikimin e sulmeve kibernetike dhe rëndësinë e lartë të infrastrukturës së OST, kërkohet gjithashtu një analizë e detajuar e qëndrueshmërisë kibernetike (Cyber Security Resilience Review), përfshirë një Gap Analysis.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) përdor sistemin SCADA/EMS si platformën kryesore të qendrës së kontrollit, duke siguruar monitorim dhe menaxhim të sigurt të sistemit të transmetimit të energjisë. Ky sistem garanton informacion të besueshëm operativ dhe mbështet vendimmarrjen për funksionimin e rrjetit.

Menaxheri i Rrjetit ofron një mjedis të standardizuar për operim optimal, duke mundësuar integrim të lehtë me sistemet e tjera të shërbimeve dhe duke ruajtur nivele të larta të sigurisë së IT. Arkitektura e tij e hapur lejon përshtatje për analiza në kohë reale, optimizim dhe planifikim afatgjatë, duke reduktuar kostot operative.

Sistemi kryesor SCADA/EMS mbulon në kohë reale të gjitha stacionet 220/400 kV dhe stacionet kryesore 110 kV, dhe është instaluar në ambientet e Qendrës së Dispeçerit Kombëtar. Infrastruktura është plotësisht redundante, si në pajisje hardware ashtu edhe në servera, duke siguruar disponueshmëri dhe besueshmëri të lartë.

Serverat e aplikacioneve operojnë në konfigurim Online/Standby, ndërsa në sistem funksionojnë dymbëdhjetë stacione pune, përfshirë dy për funksione të “Data Engineering”. Menaxhimi i përdoruesve kryhet përmes “Active Directory” dhe “Authority Manager”, me nivele të aksesit të përcaktuara sipas përdoruesit dhe stacionit të punës.

Sistemi përdor dy baza të dhënash kryesore:

-
- Baza e të dhënave në kohë reale
 - Baza e të dhënave historike/inxhinierike.

Për marrjen e të dhënave nga terreni përdoren RTU-të ose sistemet e automatizimit të nënstacioneve, ndërsa komunikimi realizohet përmes protokollit IEC 60870-5-104 në Rrjetin e Telekomunikacionit të OST sh.a.

1.1 Sistemi Emergjent i Kontrollit (ECC-Emergency Control Center)

Sistemi ECC funksionon në përputhje me Qendrën Dispeçer Kombëtare të Kontrollit (QDK), të vendosur në nënstacionin Tirana 2, duke siguruar vëzhgueshmëri të plotë të Rrjetit të Transmetimit edhe në rast dështimi të sistemit kryesor. Ai operon në mënyrë të pavarur nga SCADA/EMS i QDK, por përdor të njëjtat burime të të dhënave dhe infrastrukturë telekomunikacioni. Komunikimi midis QDK dhe ECC realizohet përmes protokollit ICCP, duke garantuar koordinim të sigurt midis dy qendrave. Ndërkohë, komunikimi i ECC me RTU-të dhe DCS-të kryhet në mënyrë të pavarur nga QDK, pa kërkuar modifikime në konfigurimet ekzistuese. Të dy sistemet marrin të dhëna në kohë reale. Transmetimi i të dhënave midis stacionit kryesor dhe nyjeve periferike bëhet përmes protokollit IEC 60870-5-101, duke përdorur një rrjet komunikimi “pika-në-pikë”.

Në sistemin ECC monitorohen dhe operohen në kohë reale të gjitha stacionet 220/400 kV, shumica e të cilave funksionojnë të pavarura nga sistemi kryesor SCADA.

Përbërja e hardware-it të ECC

Sistemi ECC përfshin pajisje dhe servera redundantë për të garantuar vazhdimësi operationale:

- Servera SCADA/AGC (redundantë)
- Servera të bazës së të dhënave (redundantë)
- Data Engineering Server
- Web Server
- NTP Server
- 4 Workstations operatorësh (me 3 monitorë secili)
- Sistem Backup dedikuar
- Switche redundant për LAN
- Routers redundant për WAN
- Firewallle redundant
- Pajisje LKKU për marrjen e të dhënave nga sistemet lokale

Software i instaluar

- PROZA NET 3 (klient)
- PNET Client Archive
- PNET Process Client
- Render (për përkthimin e komponentëve PROZA)

Protokollet e komunikimit

a) ICCP

Përdoret për komunikimin midis QDK dhe ECC, duke shmangur kontrollin simultan nga të dy qendrat.

b) IEC 60870-5

Standardi definon protokollet e komunikimit për automatizimin, përfshirë:

- IEC 60870-5-101: për funksione bazë të kontrollit mbikëqyrës (komunikim serial).
- IEC 60870-5-104: për transmetim të të dhënave përgjatë rrjeteve WAN me protokolle TCP/IP.

c) Rrjetet e komunikimit

Për të mos ndikuar në komunikimet ekzistuese të QDK me nënstacionet dhe hidrocentralet, pajisjet LKKU vendosen në segmentin e komunikimit midis ECC dhe sistemeve të largëta SCADA/PLC.

1.2 PCN Network

OST, në përputhje me direktivat e ENTSO-E, ka implementuar nyjen e komunikimit për shërbimet e **Electronic Highway**, duke u bërë pjesë zyrtare e këtij rrjeti.

Nyja është instaluar në **Qendrën Kombëtare të Kontrollit** dhe operon brenda infrastrukturës teknologjike të OST.

1.3 Electronic Highway

OST, në zbatim të direktivave të ENTSO-E, ka implementuar nyjen e komunikimit për shërbimet **Electronic Highway (EH)**, duke u bërë pjesë zyrtare e këtij rrjeti. Nyja është instaluar në **Qendrën Kombëtare të Kontrollit** dhe operon brenda infrastrukturës teknologjike të OST. Për të siguruar nivel të lartë besueshmërie dhe disponueshmërie, sistemi EH është ndërtuar me **redundancë të plotë** në:

- Routera
- Firewalle
- Switche

Siguria e sistemit garantohet përmes implementimit të tuneleve sipas rekomandimeve të fundit të ENTSO-E si dhe filtrimit të avancuar të firewall-eve.

Rrjeti EH është projektuar për të mbështetur të gjitha shërbimet e kërkuara nga ENTSO-E. Aktualisht, është funksional shkëmbimi i të dhënave ICCP në kohë reale midis:

- OST – IPTO
- OST – CGES
- OST – ENTSO-E

Të dhënat janë verifikuar me operatorët homologë dhe transmetohen sipas rregullave dhe protokolleve të ENTSO-E.

Përveç ICCP, OST ka implementuar edhe shërbimet e tjera të kërkuara nga ENTSO-E, ku EH shërben si mjet transmetimi, përfshirë:

- ENTSO-E Awareness System (EAS)
- Shërbimin FTP
- Shërbimin e postës elektronike

1.4 Sisteme Lokale SCADA

Sistemet lokale SCADA funksionojnë si nyje periferike për mbledhjen e të dhënave, duke përdorur RTU-të ose sistemet e automatizimit të nënstacioneve. Komunikimi midis SCADA/EMS kryesor dhe nyjeve periferike realizohet përmes protokollit **IEC 60870-5-104** në Rrjetin e

Telekomunikacionit të OST sh.a. Të gjitha nënstacionet 400 kV dhe 220 kV monitorohen dhe kontrollohen në kohë reale nga këto sisteme.

Funksionet kryesore të Sistemit Lokal SCADA

- Monitorimi i nënstacionit
- Marrja dhe përpunimi i informacionit
- Kontrolli i pajisjeve primare dhe sekondare
- Shfaqja e informacionit dhe alarmet
- Arkivimi dhe gjenerimi i raporteve
- Sinkronizimi i kohës
- Komunikimi me QDK dhe ECC

Redundanca e sistemit

Sistemi lokal SCADA është projektuar me redundancë të plotë në nivel serverash dhe workstation-ash, për të garantuar funksionim të pandërprerë. Serverat funksionojnë sipas parimit “**hot-standby**”, ku serveri kryesor mban komunikimin aktiv, ndërsa serveri rezervë merr automatikisht funksionet në rast:

- mosfunksionimi të serverit kryesor,
- ndërprerjes së komunikimit LAN,
- ndërprerjes së energjisë, etj.

Gjatë ngritjes së sistemit, serveri i parë merr automatikisht rolin kryesor, ndërsa i dyti shërben si backup. Edhe workstation-at janë plotësisht redundantë: secili mund të marrë funksionet e tjetrit pa ndërprerje dhe sinkronizohet automatikisht pas rikthimit në punë.

Komunikimi dhe ndërveprimi

Serverat SCADA:

- marrin dhe përpunojnë të dhënat nga IED-të,
- shpërndajnë informacionet tek workstation-at dhe qendrat e kontrollit,
- transmetojnë komandat drejt pajisjeve të terrenit.

Komunikimet ofrojnë:

- ndërveprim me pajisjet mbrojtëse dhe të kontrollit në përputhje me **EN 61850**,
- komunikim të dyanshëm me workstation-at,
- komunikim të dyanshëm me qendrat e kontrollit sipas **EN 60870-5-104**.

Ndërfaqja me qendrat e kontrollit në distancë

Komunikimi i të dhënave dhe komandave drejt QDK dhe ProzaNet realizohet përmes protokollit IEC 60870-5-104, duke mundësuar ndërveprim paralel me dy qendra kontrolli falë portave të redundantanta.

Autoriteti i kontrollit

Sistemi lokal SCADA mundëson transferimin e autoritetit të komandimit sipas dy niveleve:

- Niveli i nënstacionit
- Niveli i qendrës së kontrollit

Qendra e kontrollit merr kontrollin vetëm kur ky autorizim jepet nga nënstacioni. Nënstacioni mund të rikthejë kontrollin në çdo kohë, sipas hierarkisë operative.

1.5 Sistemi i Matjes

Menaxhimi i sistemit kryesor të matjes

Komunikimi me pikat matëse realizohet përmes rrjetit GSM/GPRS të operatorëve celularë, duke përdorur IPsec VPN dhe TCP mbi infrastrukturën OPGW të Rrjetit të Telekomunikacionit të OST sh.a.

Integrimi me SCADA dhe operatorin e tregut .

Qendra e Menaxhimit të Energjisë është e lidhur me sistemet SCADA dhe MiniSCADA përmes protokolleve IEC 60870-5-104 dhe IEC 60870-5-101, nëpërmjet ndërfaqes së Portës së të Dhënave SCADA. Sistemi i matjes transmeton të dhënat në format CSV ose XML përmes FTP, si dhe përmes ndërfaqes Web. Të dhënat mund të shkëmbehen gjithashtu edhe përmes OPC server, në funksion të operatorit të tregut.

1.6 Platforma e Operimit të Tregut / Sistemit

OST sh.a. ka detyrimin të sigurojë transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, të garantojë kontrollin efikas të sistemit energjetik të ndërlidhur me vendet fqinje dhe të zhvillojë një sistem transmetimi optimal e të qëndrueshëm, në funksion të nevojave të klientëve dhe shoqërisë. Institucioni është gjithashtu përgjegjës për sigurimin dhe zhvillimin e tregut shqiptar të energjisë, si dhe për integrimin e tij në tregjet rajonale dhe europiane.

OST sh.a. është e ndërlidhur me tre shtete fqinje në kuadër të ENTSO-E dhe duhet të operojë në përputhje me manualin operacional, rregulloret dhe praktikatat më të mira të ENTSO-E, duke ndjekur standardizimin dhe kërkesat e komunitetit evropian të transmetimit. Aktualisht, OST funksionon si Operator i Bllokut të Kontrollit për Zonën e Kontrollit të Shqipërisë dhe, së bashku me pjesëmarrësit e tregut, duhet të respektojë plotësisht Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Kodin e Tregut.

Funksionet kryesore të OST

- Alokimi i kapaciteteve ndërkufitare
- Accounting dhe Settlement
- Skedulimi ndërkufitar dhe i brendshëm
- Mekanizmi i balancimit
- Shërbimet ndihmëse
- Menaxhimi i të dhënave të energjisë
- Funksioni i Operatorit të Tregut
- Njoftimi i kontratave
- Settlement
- Platforma e Transparencës

1.7 Infrastruktura e platformës së Operimit të Tregut / Sistemit

Infrastruktura e platformës është e hostuar në **cloud**, e ndërtuar si **PaaS** me redundancë të plotë, për të garantuar nivel maksimal besueshmërie dhe disponueshmërie. Për rritjen e sigurisë janë implementuar certifikata sigurie me enkriptim të të dhënave, si dhe autentikim me faktor të shumëfishtë (MFA).

2 Objekti

Duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike të sistemeve të teknologjisë së informacionit në funksionimin e OST sh.a., kërkohet realizimi i auditimit mbikqyrës I certifikimit aktual të Standardit ISO 27001:2022 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS), me qëllim verifikimin e përputhshmërisë, efektivitetit dhe mirëmbajtjes së certifikimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Objekti i këtij prokurimi është:

- Auditimi Mbikqyrës I certifikates se standartit ISO 27001:2022

bazuar ne Certifikimin i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit të

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA), e vlerësuar në mënyrë të pavarur që është konform me kërkesat e standardit: **ISO/IEC 27001:2022**

Kjo certifikatë është e zbatueshme në fushën e mëposhtme të aktivitetit të saj:

“Transmetimi dhe dispeçerimi i tensionit të lartë (HV) dhe tensionit shumë të lartë (EHV) që i përkasin Rrjetit Kombëtar; ushtrim, komandim, kontroll dhe siguri mbi rrjetin e tensionit të lartë dhe shumë të lartë; zhvillimi I rrjetit kombëtar të transmetimit; projektim, ndërtim dhe instalim të nënstacioneve të tensionit të lartë dhe shumë të lartë; masat e mirëmbajtjes, menaxhimit dhe realizimit dhe testet e specializuara në instalimet në pronësi të OST Sh.a. dhe filialeve të saj; testimi, trajnimi dhe puna nën tension.”

Certifikatë Nr.: SMSI20241021ALOS, me aneks certifikatë që përfshin edhe

Njësitë Operative si më poshtë :

- *Njësitë Operative: Njësia e Mirëmbajtjes së Trasmetimit, Tiranë;*
- *Njësia Operative Tiranë; Rruga Siri Kodra; Nënstacioni 220 KV, Tiranë.*
- *Njësia Operative Elbasan; Nënstacioni 220 KV, Bradashesh, Elbasan;*
- *Njësia Operative Fier, Nënstacioni 220 KV; Pranë TEC Fier, Fier;*
- *Njësia Operative Korçë, Nënstacioni Zemblak, Pojan Zemblak, Korçë.*
- *Njësia Operative Shkodër, Nënstacioni 220 KV, Vau i Dejës, Shkodër;*
- *Njësia Operative Burrel; Nënstacioni 220 KV, Koms, Burrel, Dibër;*

2.1 Përfitimet nga certifikimi sipas standardit ISO

Zbatimi dhe certifikimi sipas standardit ISO 27001:2022 kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës organizative të OST sh.a., duke garantuar menaxhim efektiv të sigurisë së informacionit dhe mbrojtje të aseteve kritike. Certifikimi, i arritur përmes një auditimi të suksesshëm të përputhshmërisë, i mundëson institucionit:

- Të operojë me efikasitet më të lartë organizativ dhe operacional;
- Të përmbushë kërkesat ligjore dhe rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të forcojë bashkëpunimin me institucionet homologe dhe partnerët strategjikë;
- Të identifikojë, vlerësojë dhe trajtojë në mënyrë sistematike risqet e aktivitetit;
- Të garantojë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit dhe sistemeve të TI;
- Të ofrojë siguri dhe besueshmëri ndaj qytetarëve dhe palëve të treta mbi përmbushjen e standardeve më të larta të sigurisë së informacionit;
- Të rrisë reputacionin dhe besueshmërinë institucionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2.2 Sistemet e menaxhimit ISO

Adoptimi dhe zhvillimi i sistemeve të menaxhimit sipas standardeve ISO përbën një vendim strategjik për OST sh.a., duke mundësuar përmirësim të vazhdueshëm të performancës organizative dhe ofrim shërbimesh me cilësi të lartë, me ndikim minimal negativ ndaj qytetarëve dhe shoqërisë.

Për të garantuar dokumentimin e proceseve, procedurave, përgjegjësive dhe arritjen e objektivave institucionale në fushën e cilësisë, sigurisë, mjedisit dhe energjisë, OST sh.a. ka ndërtuar dhe implementuar një Sistem të Integruar Menaxhimi në përputhje me standardet nderkombetare dhe ka implementuar sisteme menaxhimi të integruara sipas:

- ISO 27001:2022

ISMS është ndërtuar sipas strukturës së re të ISO 27001:2022, duke përfshirë:

- Kontekstin e organizatës
- Leadership
- Planifikim dhe risk management
- Mbështetje
- Operim
- Vlerësim performance
- Përmirësim

2.3 Standardi ISO që duhet audituar dhe mirëmbajtur në OST sh.a.

Referuar kërkesave të standardit të certifikimit sipas standartit ISO 27001-2022, në përputhje me kërkesat e institucioneve rregullatore përkatëse, përfshirë ERE dhe AKSK, si dhe me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në ENTSO-e, OST sh.a. kërkon realizimin e shërbimeve si më poshtë:

- Kryerjen e Auditimit Mbikqyres ISO 27001:2022 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS), në kuadër të ciklit të mirëmbajtjes së certifikimit.

3 Kërkesat e auditimit dhe mirëmbajtjes të ISO27001 në OST Sh.A

3.1 Auditimi i sistemit

Procesi duhet të udhëhiqet dhe auditohet nga një trupe certifikuese e akredituar .

Kjo kërkon një auditim të integruar me specialistë dhe teknikë mbi normat ISO27001 të menaxhimit dhe mbi aktivitetin që ofron OST Sh.a.

Gjatë fazës së auditimit duhet të realizohet një vlerësim i integruar i përputhshmërisë me kërkesat e standardit, si në nivel menaxherial ashtu edhe në nivel teknik.

Në përfundim të procesit duhet të dorëzohen:

- Raporti përfundimtar i auditimit (në format fizik dhe digjital);
- Lista e gjetjeve (moskonformitete, vërejtje, rekomandime) (në format fizik dhe digjital);
- Përshkrimi i masave dhe planit të trajtimit të risqeve të identifikuara (në format fizik dhe digjital).

Auditimi duhet të mbulojë të gjitha spektrin e përfshirë në certifikimin sipas standartit ISO 27001:2022 duke përfshirë në mënyrë të plotë politikat dhe procedurat që lidhen me të, përfshirë:

- Kontekstin organizativ, palët e interesuara dhe fushëveprimin e ISMS;

- Udhëheqjen, rolet dhe përgjegjësitë organizative;
- Menaxhimin e riskut, objektivat dhe planifikimin;
- Kompetencën, ndërgjegjësimin, komunikimin dhe kontrollin dokumentar;
- Monitorimin, auditimin e brendshëm dhe veprimet korigjuese;
- Menaxhimin e asetëve, klasifikimin dhe trajtimin e informacionit;
- Kontrollin e aksesit, menaxhimin e privilegjeve dhe autentikimin;
- Kriptografinë, menaxhimin e çelësve dhe sigurinë e kodit burim;
- Sigurinë fizike dhe mjedisore;
- Sigurinë e operacioneve, backup, mbrojtjen nga malware dhe menaxhimin e ndryshimeve;
- Sigurinë e komunikimeve dhe segmentimin e rrjeteve;
- Marrëdhëniet me palët e treta;
- Menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit;
- Vazhdimësinë e biznesit (BCP/DRP)

3.2 Mirëmbajtja e certifikimit ISO 27001-2022

Objektivi i përgjithshëm i këtij shërbimi është realizimi i auditimit mbikqyrës vjetor (Surveillance Audit) dhe mirëmbajtjes së certifikimit ISO 27001:2022 për OST sh.a., nga një trupë e akredituar certifikuese, në përputhje me ciklin periodik të certifikimit dhe kërkesat e standardit. Shërbimi duhet të sigurojë verifikimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë së Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS), si dhe ruajtjen e vlefshmërisë së certifikatës.

I gjithë aktiviteti, përfshirë planifikimin, realizimin e auditimit, raportimin dhe përfundimin e procedurës së Auditimit Mbikqyrës të certifikimit, duhet të përfundojë brenda një afati maksimal prej 51 ditë kalendarike nga data e fillimit të kontratës, sipas tabelës të paraqitur më poshtë:

Nr.	Fazat e Auditimit Mbikqyrës per Certifikimin ISO 27001-2022	Ditë pune
1	Shqyrtimi i transferimit të certifikimit. <i>Verifikimi i certifikatës ekzistuese, raporteve të mëparshme.</i>	10 ditë pune
2	Planifikimi i Auditimit. <i>Përcaktimi i objektivave, fushës së auditimit dhe hartimi i planit të auditimit</i>	10 ditë pune
3	Rishikimi i dokumentacionit Auditimit. <i>Shqyrtimi i dokumentacionit ISMS.</i>	10 ditë pune
4	Auditimi mbikqyrës (on-site) <i>Verifikimi i implementimit nëpraktike, shqyrtim dokumentacioni, verifikim i infrastruktures onsite. Identifikimi i moskonformiteteve, vërejtje dhe adresimi i tyre.</i>	10 ditë pune
5	Përgatitja dhe dorëzimi i raportit të auditimit. <i>Hartimi i raportit përfundimtar dhe rekomandimet e dala nga auditimi mbikqyrës mbi certifikatën në fuqi.</i>	10 ditë pune
6	Vendimi për vazhdim të certifikimit.	1 ditë pune
TOTALI		51 ditë pune

Bazuar në raportin përfundimtar të auditimit mbikqyrës, mund të kërkohet hartimi i politikave dhe procedurave shtesë ose përditësimi i atyre ekzistuese, me qëllim adresimin efektiv të risqeve të identifikuara dhe forcimin e vazhdueshëm të nivelit të sigurisë së informacionit në përputhje me kërkesat në vazhdimësi të standartit ISO 27001:2022.

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare (2025-2024-2023), te paktën 900,000 (nëntëqind mijë) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shenim: Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese shembuj te certifikimit sipas standardit ISO 27001.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i akreditur nga enti i akreditimit shteteror shqiptar, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, kjo e deshmuar me certifikate leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga ente akredituese nderkombetare te njohura ne Republiken e Shqiperise, si pjese e IAF dhe/ose EA.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) konsulent per hartimin e dokumentacionit, implementimin dhe asistencen per standardin ISO/IEC 27001: . Kjo e vertetuar nga dokumentacione te ndryshme (trajtime, ekspierenca pune, CV, vertetime nga kompani te ndryshme, libreze pune, listepagesen e fundit e-sig). Gjithashtu OE te kete pjese te stafit te tij, ose te kontraktuar me qellim realizimin e kesaj procedure prokurimi, 1(nje) person me kualifikime apo trajtime te ndryshme mbi ISO 27001 ose Sigurine e te Dhenave apo Informacionit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.4 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

